

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË – DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE**

Gjyqtarja Lirije Kaferxholli me Sek.juridike Belkize Gashi në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Lulzim Adem Berisha nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 5 dhe 6 paragraf 1.3 dhe neni 9 të Ligjit për deklarimin, preeejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave zyrtare të lartë publik, si dhe në bazë të nenit 73, 195 dhe 199 të Ligjit mbi kundërvajtje, me dat. 22.10.2013 merrë këtë:

**A K T V E N D I M**

**I PANDEHURI:** Lulzim Adem Berisha I lindur me dt. 08.03.1976 në Prishtinë Rr." Ulpiana U 1 hyrja 1 nr.17, ku dhe tani jeton I martuar I ati 2 femive, k ate kryer fakultetin ekonomik, gjerë me tani kinse jo I denuar.

**Ë S H T Ë P Ë R G J E G J Ë S**

Sepse si zyrtar i lartë publik – Këshilltar I ansambles komunale në Suharekë nuk e ka bërë deklarimin e pasurisë për vitin 2011 në Agjencionin kundër Korrupsionit në Prishtinë në afat ligjor prej 01 deri 31.03.2012 sipas kërkesës së Agjencionit kundër korrupsionit.

Me këtë veprim i pandehuri ka kryer kundërvajtje nga neni 5 dhe 6 paragraf 1.3 dhe neni 9 të Ligjit për deklarimin, preeejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave zyrtare të lartë publik, e me aplikimin e të njëjtit konform nenit 10 të Ligjit mbi kundërvajtje i shqiptohet:

**Q O R T I M I**

Të pandehurit i shqiptohet masa e **QORTIMIT** në bazë të nenit 10 të Ligjit mbi kundërvajtje. Shpenzimet e procedurës i barte gjykata.

Me nga një egzemplar të këtij aktvendimi të njoftohet parashtrusi i kërkesës dhe i pandehuri.

**A r s y e t i m**

Me kërkesën e Agjencionit Kundër Korrupsionit në Prishtinë me nr. 01 nr.16 -776 të dt. 10.12.2012 është ngritur procedura kundërvajtëse ndaj të pandehurit me motivacion se ka kryer kundërvajtje nga neni 5 dhe 6 paragraf 1.3 dhe neni 9 të Ligjit për deklarimin, preardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave zyrtare të lartë publik, dhe deklarimin, preardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar.

Gjykata mori në pyetje të pandehurin Lulzim Berisha I cili ka deklaruar : punoj në një firmë private, niherit jame Këshilltar Komunal – Suharekë dhe se asnjë here nuk e kame bërë deklarimin e pasurisë pasi që nuk është kerkuar nga AKK, për vitin 2011 nuk kame qenë I njoftuar në asnjë menyrë që ta bëjë deklarimin e pasurisë andaj nuk e kam plotsuar formularin me kohe për deklarimin e pasurisë në afatin që është I percaktuar me ligj 01.03 deri në 31.03.2012 pasi që unë nuk kame qenë I njoftuar si nga agjencioni poashtu edhe nga Kuvendi I Komunes - Suharekës, une jame njoftuar nga gjykata e cila me ka derguar një ftes që të me merre në pyetje për mos deklarimin e pasurisë, menjehere une e kamë plotësuar formulërin për deklarimin e preardhjes dhe gjendjes së pasurisë me dt. 23.11.2011 dhe ia kam derguar AKK në Prishtinë ku gjykates si prove ia prezentoj vertetimin të leshuar nga Agjencioni kundër korrupsionit. Nuk kame patur kurrfar qëllimi që mos ta deklaroj pasurinë pasi që komplet të ardhurat nga pagat të cilat I marre si Këshilltar Komunal ua kame dedikuar studentave – fondacioni "Hajdin Berisha".

Gjykata për vertetimin e gjendjes faktike muar në pyetje në cilësi të dëshmitarit përfaqësuesin AKK- – Prishtinë – Agron Behrami I cili ka deklaruar : në hyrje në fuqi të Ligjit të ri për deklarimin, preardhjen e pasurisë 04/L-050 kanë për obligim që edhe Këshilltarët Komunal të bëjnë deklarimin, preardhjen e pasurisë gjatë muajit Mars të çdo viti kalenderik .AKK ka filluar pregaditjet për deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë si dhe deklarimin sipas kërkesës së agjencisë për zyrtar të lartë publike të cilët nuk kanë patur me heret obligim për deklarimin e pasurisë ,njoftimet i kemi shpërndarë të gjithë zyrtarëve kontaktues neper institucione, zyrtarët kontaktues kanë për obligime të njoftojnë zyrtarët e lartë publik me pajtim të nenit 4 të Ligjit të lartë përmendur . AKK ka kontrolluar listat e zyrtarëve të lartë publik dhe ka konstatuar se zyrtari I lartë publik Lulzim Berisha nuk ka paraqitur deklarimin e pasurisë sipas kërkesës së AKK –së, andaj kemi paraqitur kërkesë për iniciimin e procedurës kundërvajtëse ndaj tij për kundërvajtje nga neni 5 dhe 6 paragrafi 1.3 dhe neni 9 dhe neni 17 paragrafi 1.3 I njëjti nuk ka bërë deklarimin e pasurisë prej 1 deri me 31 mars 2012 për vitin paraprak-2011 pranë AKK – në Prishtinë. AKK ka shpërndarë njoftimit edhe përmes email-it si dhe të njëjtin njoftim e ka publikuar në web faqe të agjencisë së AKK.

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVAIREPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGJENCIA PROTIV KORUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr Prot
Dep. <b>DPK/DMP</b>	Br Prot
Dep.	Prot No <b>03-3771/13</b>
Nr i ftoj	Date
Groj. stranca	Datum <b>07.11.2013</b>
Nr. pages <b>02</b>	Dat.
PRISHTINE	



03-3771/13/02  
serg

Gjykata muar ne pyetje deshmitarin Ragip Sadikaj: jame I caktuar nga Kryetari I Komunes së Suharekës si zyrtar I pikes kontaktuse ne mes te Komunes se Suharekës dhe AKK –së -Prishtinë. Sa I perket lendes e cila është e ngritur kundër Lulzim Berishen nga Suhareka për mos deklarim te pasuris deklaroi se materjalin e nevojshem sebashku me formularin e AKK-së – Prishtinë dhe njoftimin ia kamë dhene shperndarsit te postes ( punetorit te Kuvendit te Komunes) që t'a dorzoj keti personit. I njeiti me ka njoftuar se ia ka dorzuar te atit te personit ne fjalë, gjykates si prove ia prezenton fletedorzimin e dt. 02.03.2012 mbi pranimin e njoftimit mbi deklarimin e pasuris te cilen e ka pranuar I ati te pandehurit.

Andaj gjykata pas administrimit dhe vlerësimit te te gjitha provave , konstatoj se i pandehuri ka kryer kundërvajtje siqë është e cekur në dispozitiv të këtij aktvendimit, mirëpo konform nenit 10 të Ligjit mbi Kundërvajtje ia shqiptoj masën e QORTIMIT me bindje so do të arrihet efekti dhe qellimi i denimit.

Me rastin e shqiptimit të denimit janë vlersuar rrethanat në të cilat është kryer kundërvajtja, se është hera e pare qe i pandehuri ka kryer keso lloj kundervajtje, pra duke patur parasysh rrethanat lehtësuse dhe rënduse e në pajtim me nenin 10 të Ligjit mbi Kundërvajtje ia shqiptoj **QORTIMIN** me bindje se do të arrihet qellimi i denimit tek i pandehuri dhe do të ndikoj pozitivisht që në të ardhmën mos të perseris vepra të tilla kundërvajtëse, Gjykata si rrethanë lehtësuse muar se I pandehuri per here te pare ka kryer keso kundervajtje dhe se e ka deklaruar pasurinë me date 23.11. 2012 ku gjykates ia prezentoj Vertetimin te leshuar nga AKK- Prishtinë ,ndersa si rrethanë rënduese gjykata muar peshën e kundervajtjes se kryer.

Më sa u cekë më lartë u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

#### GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË – DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE.

Sek.juridike  
Belkize Gashi



**UDHZIME JURIDIKE:** Pala e pa kënaqurë kundër këtij Aktvendimi ka të drejtë ankese Gjykates së Apelit në Prishtinë, - Devizioni per Kundervajtje në afat prej 8 ditësh pas marrjes së të njejtit nëpërmes të kësaj Gjykate.